

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR 146/15

(P. nr. 958/2012 Gjykata Themelore e Prishtinës, më 6 nëntor 2014)

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Roman Raab, kryetar dhe gjyqtar raportues, gjyqtares së EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova dhe gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Driton Muharremi, anëtarë të kolegjit, me asistimin e këshilltares ligjore të EULEX-it Vjollca Kroci-Gerxhaliu, e cila vepron në cilësinë e procesmbajtëses, në seancën publike të mbajtur më 1 tetor 2015 lidhur me të pandehurit:

1. **S.M.**, me nofkën xxx, emri i të atit xxx, xxx i lindur më xxx në xxx Xxx, komuna e Xxx me vendbanim në xxx, komuna e xxx, xxx, shtetas xxx, xxx, xxx, xxx;
2. **S.M.1.**, me nofkën xxx emri i të atit xxx xxx, i lindur më xxx në xxx Xxx dhe me vendbanim në xxx Xxx, komuna e xxx, xxx, shtetas xxx, xxx, xxx, xxx;
3. **S.S.**, me nofkën xxx emri i të atit xxx, xxx, e lindur më xxx, vendi i lindjes i panjohur, me vendbanim në xxx Xxx, komuna e xxx, xxx, shtetase xxx, xxx, xxx, xxx;

të akuzuar me aktakuzën PPS nr. 240/09 të datës 20 nëntor 2010, dhe të **liruar** me aktgjykimin **P. nr. 958/2012 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, të datës 6 nëntor 2014** lidhur me këto vepra penale:

(Pika një): Krime lufte kundër popullsisë civile në kundërshtim me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP të RSFJ-së), aktualisht e dënueshme me nenet 23 dhe 120 (2) të Kodit Penal të Kosovës (KPK), në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949 (neni i përbashkët 3) dhe me nenet 1 dhe 17 të Protokollit II të datës 8 qershor 1977, shtesë e Konventës së Gjenevës 1949 (Protokolli Shtesë II), të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë gjatë gjithë kohës e cila ka të bëjë me akuzat e tanishme të të pandehurve në cilësinë e tyre si pjesëtarë të ushtrisë ose paramilitarë serbë, përfshirë personat S.F., I. P., D.T., S. T. dhe N.P., kanë trajtuar në mënyrë çnjerëzore S. B. dhe H.D., dy civilë që nuk kanë marrë pjesë në luftime, duke i mbajtur të mbyllur në kushte çnjerëzore (të tilla si ndyrësi, mungesë ushqimi, mungesë uji dhe mungesë kujdesi mjekësor) në dhe përreth Xxx në mes të datave 19 dhe 22 prill 1999;

(Pika dy): Krime lufte kundër popullsisë civile në kundërshtim me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së), aktualisht e dënueshme me nenet 23 dhe 120 (2) të Kodit Penal të Kosovës, në kundërshtim me nenet e përbashkëta 3, 1 dhe 17 të Protokollit Shtesë II, të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës e cila ka të bëjë me akuzën e tanishme të të pandehurve në cilësinë e tyre si pjesëtarë të ushtrisë apo paramilitarë serbë, duke përfshirë personat D. T., S. T.

dhe N. P., kanë shkelur integritetin trupor dhe shëndetësor të S.B.dhe të H.D., dy civilë që nuk kanë marrë pjesë në luftime, duke i rrahur në vazhdimësi në dhe përreth Xxx në mes të datës 17 dhe 21 prill 1999;

dhe

në përputhje me nenin 390 (3) të KPPK-së, **S.S.** është liruar nga:

(Pika tre): Krime lufte kundër popullsisë civile në kundërshtim me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së), aktualisht e dënueshme me nenet 23 dhe 120 (2) të Kodit Penal të Kosovës, në kundërshtim me nenet e përbashkëta 3, 1 dhe 17 të Protokollit Shtesë II, të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante me fazën aktuale të të pandehurës në cilësinë e polices ose paramilitares serbe, në bashkëkryerje me zyrtarët e tjerë ushtarak ose paramilitarë serbë, ka shkelur integritetin trupor dhe shëndetësor të S.B. dhe të H.D., dy civilë që nuk kanë marrë pjesë në luftime, duke i rrahur dhe posaçërisht duke e goditur H.D., në kokë me hu druri në Xxx më ose rreth datës 21 prill 1999.

duke vepruar sipas

ankesës së prokurorit special PPS nr. 240/09 e parashtruar më 15 janar 2015¹ kundër aktgjykimit P. nr. 958/2012, të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 6 nëntor 2014 me të cilin të pandehurit janë liruar nga të gjitha akuzat;

pas marrjes parasysht të:

përgjigjes ndaj ankesës së prokurorit, të parashtruar nga avokati mbrojtës Miodrag Brkljać, në emër të të pandehurit **S.M.** të datës 28 janar 2015 si edhe përgjigjen e avokatit mbrojtës Živojin Jokanović në emër të të pandehurës **S.S.**, të datës 29 janar 2015;

propozimit të prokurorit të apelit PPA/I.nr. 147/15, të datës 18 mars 2015 dhe të parashtruar më 19 mars 2015;

pas mbajtjes së seancës së apelit më 1 tetor 2015, në përputhje me nenin 411 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tash e tutje në këtë tekst: KPPK)²;

pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më 2 tetor 2015;

në përputhje me nenin 420 të KPPK-së

sjell këtë

AKTGJYKIM

¹ Version në gjuhën angleze i ankesës është vulosur nga Gjykata Themelore e Prishtinës më 15 janar 2015, ndërsa versioni shqip i ankesës është vulosur më 13 janar 2015. Të dy versionet e ankesës janë të datës 11 janar 2015.

² Kodi i Procedurës Penale në fuqi deri më 31 dhjetor 2012.

- **Refuzohet si e pabazë ankesa e prokurorit special të Republikës së Kosovës kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës P. nr. 958/2012, të datës 6 nëntor 2014;**
- **Vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës P. nr. 958/2012, i datës 6 nëntor 2014.**

ARSYETIM

1. Historiku i deritanishëm i procedurës

Prokurori special i Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzën PPS nr. 240 /09 kundër **S.M., S.M.1**dhe **S.S.**, më 20 nëntor 2010 për veprat e përmendura penale. Aktakuza është konfirmuar në tërësi më 31 mars 2011.

Seanca e parë e shqyrtimit gjyqësor ka filluar më 7 qershor 2011 para kolegjit të (atëherë) Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar vendor. Seancat e tjera të shqyrtimit gjyqësor janë mbajtur më datat 16 qershor, 13 korrik, 14 korrik, 19 korrik dhe 20 korrik 2011. Kolegji i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës ka shpallur aktgjykimin më 22 korrik 2011 dhe të gjithë të akuzuarit i ka shpallur të pafajshëm sepse nuk ishte provuar se ata kishin kryer veprat penale për të cilat akuzoheshin.

Prokurori i PSRK-së ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës më 8 nëntor 2011.

Më 1 janar 2013, lënda është kaluar nga Gjykata Supreme, si gjykatë më parë kompetente e shkallës së dytë, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në përputhje me nenin 39, par. (1) të Ligjit mbi gjykatat, Ligji nr. 03 / L - 199.

Më 25 korrik 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës ka marrë aktvendimin PAKR 978/12, me të cilin ishte prishur aktgjykimi i shkallës së parë dhe lënda ishte kthyer në rivendosje dhe rigjykim në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Rigjykimi ka filluar më 4 nëntor 2013 në lokalet e Gjykatës Themelore të Prishtinës. Të pandehurit nuk e kanë pranuar fajësinë. Seancat e gjykimit janë mbajtur më 23 nëntor 2013, 9 dhjetor, 10 dhjetor dhe 18 dhjetor 2012, pastaj më 21 janar 2014, 25 mars 2014, 29 prill 2014, 9 qershor, 14 korrik 2014, 15 korrik 2014, 5 gusht 2014, 16 shtator 2014, 13 tetor , 17 tetor , 29 tetor 2014, 6 nëntor 2014. Në seancën e fundit, pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit, në praninë e të gjitha palëve, kolegji ka shpallur aktgjykimin e Gjykatës Themelore P. nr. 958/2012 me të cilin të gjithë të pandehurit u liruan.

Prokurori special ka parashtruar ankesë ndaj aktgjykimit P. nr. 958/2012 të Gjykatës Themelore të Prishtinës (tash e tutje në këtë tekst: aktgjykimi i ankimuar), të datës 6 nëntor 2014.

2. Aktgjykimi i ankimuar

Me aktgjykimin e ankimuar të datës 6 nëntor 2014, në përputhje me nenin 390 paragrafin 3 të KPPK-së, të pandehurit u liruan sepse nuk ishte provuar se të njëjtit kishin kryer veprat penale për të cilat u akuzuan. Me aktakuzën PPS 240/09, të datës 20 nëntor 2010, të pandehurit **S.M., S.M.1.** dhe **S.S.** akuzohen për këto vepra penale:

Krime lufte kundër popullsisë civile në kundërshtim me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së), aktualisht e dënueshme me nenet 23 dhe 120 (2) të Kodit Penal të Kosovës (KPK), në kundërshtim me nenin e përbashkët 3, i përbashkët për Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 (neni i përbashkët 3) dhe nenet 1 dhe 17 të Protokollit II të datës 8 qershor 1977, shtesë e Konventave të Gjenevës 1949 (Protokolli Shtesë II), të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës e cila ka të bëjë me akuzën e tanishme:

1. **Të pandehurit S.M. dhe S.M.1.** në cilësinë e tyre si pjesëtarë të strukturave ushtarake dhe paramilitare serbe, në bashkëkryerje me S.F., I. P., D. T., S. T., S. T. dhe N. P., kanë trajtuar në mënyrë çnjerëzore personat civilë S. B. dhe H. D., duke i mbajtur të mbyllur në kushte çnjerëzore të tilla si ndyrësi, mungesë ushqimi, mungesë uji dhe mungesë kujdesi mjekësor në dhe përreth Xxx në mes të datave 19 dhe 22 prill 1999;
2. **Të pandehurit S.M. dhe S.M.1.** në cilësinë e tyre si pjesëtarë të strukturave ushtarake dhe paramilitare serbe, në bashkëkryerje me njëri tjetrin dhe me zyrtarët ushtarak dhe paramilitarët serbë përfshirë D.T., S.T., S. T. dhe N. P., kanë shkelur integritetin trupor dhe shëndetësor të S.B.dhe të H.D., duke i rrahur në vazhdimësi në dhe përreth Xxx, në mes të datave 17 dhe 22 prill 1999;
3. **E pandehura S.S.,** në cilësinë e polices serbe ose pjesëtares së strukturave paramilitare, ka shkelur integritetin trupor dhe shëndetësor të S.B.dhe të H.D., duke i rrahur dhe në veçanti, duke e goditur H. D. në kokë me hu druri në Xxxx më ose rreth datës 21 prill 1999;

Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se të pandehurit nuk i kishin kryer krimet për të cilat u akuzuan sepse faktet përkatëse kishin mbetur të paprovuara. Ekziston vetëm deklarata e palës së dëmtuar S.B. e cila i inkriminon të pandehurit. Si rezultat i mospasjes së provave për ta vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit kishin marrë pjesë në krimet për të cilat ata u akuzuan, gjykata e shkallës së parë i ka liruar këta të pandehur prej të gjitha akuzave.

3. Parashtrësit e palëve

3.1 Ankesa e prokurorit special

Ankesa e prokurorit të SPRK-së është e parashtruar në kohë por është e pabazë. Prokurori i PSRK-së e ka apeluar aktgjykimin me ankesën e datës 15 janar 2015, për shkak të:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale në bazë të nenit 403, par. 1, pikës 12 dhe par. 2, pikës 1 të KPPK-së; dhe
- Vërtetimit të gabueshëm të fakteve në bazë të nenit 405, par. 2 të KPPK-së.

Lidhur me arsyen e parë të ankesës në fjalë, prokurori i PSRK-së paraqet se aktgjykimi në fjalë është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me njërën prej provave të rëndësishme – raportin e ekspertizës lidhur me aspektin psikologjik të dëshmisë së palës së dëmtuar S.B. Parashtruesi i ankesës thekson se ekspertiza është siguruar pas nismës së trupit gjykues dhe nuk është propozuar prej palëve. Përkundër profesionalizmit të ekspertëve, gjykata e ka neglizhuar në tërësi mendimin e tyre. Në të përmenden shpjegimet lidhur me motivimin e palës së dëmtuar B. për ta dhënë deklaratën, karakteristikat e përgjithshme të personalitetit të tij dhe orientimi i tij në procedurën penale. Si pasojë e kësaj, i dëmtuari vlerësohet i paaftë për ta përkujtuar drejt dhe në mënyrë precize ngjarjen në fjalë dhe për t'i njohur gjërat dhe personat.

Për më tepër, përmenden edhe kontradiktat lidhur me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë. Në të vërtetë, këto janë prezantimet e shpjegimit të dëshmitarit N.K. lidhur me furnizimin me ushqime nga i pandehuri S.M., njohuritë e dëshmitarit R. K. lidhur me sjelljen e keqe apo të dhunshme të të pandehurit të njëjtë gjatë luftës dhe deklaratat e dëshmitarëve B. R., F. R. dhe F.M. lidhur me shfrytëzimin e uniformës ushtarake nga i pandehura S.S..

Lidhur me nenin 430, par. 2, pikën 1 të KPPK-së, prokurorja e PSRK-së shpreh mendimin e saj se gjykata e shkallës së parë i ka përsëritur gabimet e aktgjykimit të parë. Ajo na përkujton se aktgjykimi i parë ishte anuluar për shkak se ishte mbështetur kryesisht në deklaratën e të dëmtuarit S. B., të datës 21 shtator 2000, e cila ishte marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore për deklaratat e dëshmitarëve. Përkundër arsytimit preciz të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të datës 25 korrik 2013, gjykata e shkallës së parë e ka trajtuar deklaratën e përmendur më lart të të dëmtuarit si provë tërësisht të besueshme me një peshë të lartë provuese. Duke e krahasuar këtë deklaratë me deklaratat e mëvonshme të të dëmtuarit S. B. dhe duke i theksuar dallimet në mes tyre, gjykata e justifikon vlerësimin e të dëmtuarit në fjalë si dëshmitar jo i besueshëm.

Më tutje, ajo pohon edhe shumë fakte të tjera të cilat nuk përmenden në deklaratën e parë të të dëmtuarit S. B. të datës 21 shtator 2000, por të cilat konsiderohen si fakte të provuara. Në esencë, aktgjykimi justifikohet në mënyrë ekskluzive me mospërputhje të deklaratave të të dëmtuarit të cilat nuk janë marrë në pajtim me dispozitat e ligjit procedural në fuqi në kohën kur janë marrë këto deklarata.

Parashtruesi i ankesës prandaj konsideron se aktgjykimi i bazuar në këto prova përmban shkelje esenciale të dispozitave të përmendura më lart të KPPK-së. Gabimet e bëra nga policia gjatë procedurës preliminare kanë rezultuar në konsideratën e gabueshme të të dëmtuarit në fjalë si dëshmitar jo i besueshëm dhe si pasojë e kësaj kemi ardhur deri tek një vendim i padrejtë i formës së prerë.

Lidhur me arsyet e ankesës – vërtetim i gabueshëm i gjendjes faktike, theksohen udhëzimet e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (Tribunali) mbi marrjen e aktgjykimit dënues duke u mbështetur vetëm në një dëshmitar të vetëm, siç theksohet në aktgjykimin e shkallës së parë. Lidhur me motivin bazë të dëshmitarit S. B. kjo konstatohet nga ekspertët si “drejtësi e jo

hakmarrje”. Çështja e identifikimit të të pandehurve nga dëshmitari nuk është relevante në këtë lëndë, pasi që i dëmtuari ka jetuar tërë jetën në të njëjtin fshat me ta, prandaj në asnjë mënyrë nuk mund të gabojë në identifikimin e tyre. Kjo është arsyeja pse dëshmitari S.B. i plotëson të gjitha kushtet e Tribunalit dhe çfarëdo vlerësimi tjetër i bërë nga gjykata është vlerësim i gabueshëm.

Më tutje, pohohet se është bërë vlerësim i gabueshëm i deklaratave të dëshmitarëve të tjerë. Përkitazi me këtë pikë, thuhet se janë interpretuar gabimisht deklaratat e dëshmitarëve F. N., F. I. dhe R. N., me të cilat konfirmohet se janë furnizuar me ushqime dhe cigare nga i pandehuri S.M.. Të gjithë këta kanë deklaruar se personat të cilët i kishin rrahur kanë qenë të maskuar, prandaj nuk kanë pasur mundësi t’i identifikonin. Deklaratat e tyre në asnjë mënyrë nuk provojnë se i pandehuri në fjalë nuk ka qenë në mesin e këtyre sulmuesve.

Rrethanat e lidhjes së syve të të dëmtuarit S. B. dhe saktësia e përshkrimit të tij lidhur me këtë çështje, e shtjelluar nga gjykata e shkallës së parë, nuk ka ndonjë rëndësi të madhe për shkak se ka kaluar shumë kohë nga ngjarjet në fjalë dhe lidhja e syve të tij është margjinale krahasuar me presionin e shkaktuar nga gjendja e përgjithshme e të dëmtuarit në fjalë në atë kohë. E njëjta gjë vlen edhe për uniformat dhe gradat e të pandehurve. Përkundrazi, mungesa e pakontestueshme e interesit të të pandehurve lidhur me arsyet e arrestimit të komshiut të tyre B. provon një vlerë të vogël provuese të të dëmtuarit për të akuzuarit. Po ashtu, theksohet edhe kontesti i të akuzuarit S.M. me të dëmtuarin S. B. nga viti 2008.

Sa i përket të pandehurës S.S., ankesa e kundërshton konstatimin e gjykatës se nuk ka prova nëse e pandehura ka qenë e angazhuar në ndonjë veprim ushtarak apo jo. Lidhur me këtë citohen deklaratat e dëshmitarëve B.R., F. R. dhe F. M.. Vetë fakti se i dëmtuari H.D. është gjuajtur me kërcu (cung) në kokë theksohet si fakt kryesor, përderisa rrethanat e veshjes së uniformës apo pjesëve të saj nga e pandehura janë të dorës së dytë.

Prokurori i PSRK-së konsideron se ka mospërputhje siç pohohet në deklaratat e të dëmtuarit S.B. duke iu referuar vetëm dy rrethanave sekondare. Për më tepër, deklaratat e tija nuk kanë qenë kurrë në kundërshtim me faktet kryesore. Kështu, parashtruesi i ankesës konsideron se provat e mbledhura janë të mjaftueshme për ta konfirmuar fajësinë e të pandehurve dhe propozon që ankesa të miratohet në tërësi dhe të ndryshohet aktgjykimi lirues duke i shpallur të tre të pandehurit fajtorë për veprat penale për të cilat akuzohen dhe duke i dënuar në përputhje me ligjin, apo që të anulohet aktgjykimi dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

3.2. Mendimi i prokurorit të apelit

Prokurori i apelit në tërësi pajtohet me pretendimet e prokurorit special, duke konstatuar shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale, që reflektohet në faktin se dispozitivi i aktgjykimit nuk përputhet me arsyetimin dhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Më tutje, prokurori gjen se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabueshme dhe jo të plotë, siç thotë ai gjykata nuk i marrë parasysh provat e rëndësishme, pikërisht dëshmitë e palëve të dëmtuara S.B. dhe H.D.. Ai thekson se nga dëshmia e tyre kuptohet se të pandehurit janë angazhuar dhe kanë qenë të uniformuar në kuadër të njësive paramilitare të ish-regjimit jugosllav gjatë periudhës përkatëse

kohore dhe kanë abuzuar në mënyrë jonjerëzore dhe i kanë rrahur palët e dëmtuara edhe pse ata kishin qenë civilë të cilët nuk kanë qenë të implikuar në konfliktin e armatosur. Duke mos i marrë parasysh këto fakte, gjykata i ka liruar të pandehurit në fjalë duke konsideruar se nuk është provuar se të pandehurit i kanë kryer krimet për të cilat ishin akuzuar. Si pasojë e kësaj, është shkelur ligji penal duke mos i zbatuar dispozitat ndëshkuese penale të tij.

3.3. Përgjigjet në ankesë

Të dy mbrojtësit kanë parashtruar përgjigjet e veta në ankesë, përkatësisht mbrojtësi Miodrag Brkljać për të pandehurin **S.M.** ndërsa mbrojtësi Živojin G. Jakanović për të pandehurën **S.S.**

Mbrojtësi Miodrag Brkljać në përgjigjen e tij ndaj ankesës propozon që ankesa të refuzohet si e pabazë, dhe të konfirmohet aktgjykimi i shkallës së parë. Ai në tërësi iu referohet argumenteve përfundimtare para gjykatës së shkallës së parë dhe përgjigjes së tij në ankesë në procedurën e mëhershme duke pretenduar se pohimet e prokurorit special nuk sjellin asnjë argument të ri në këtë fazë të procedurës.

Mbrojtësi Živojin G. Jakanović propozon që të refuzohet si e pabazë ankesa dhe të konfirmohet aktgjykimi i shkallës së parë, duke theksuar se vetëm dy nga dëshmitarët e kishin përshkruar të pandehurën S.J. se e kishte pasur të veshur uniformën ushtarake, për dallim nga dhjetë dëshmitarët tjerë të cilët e kishin mohuar këtë gjë. Mbrojtësi megjithatë i ka theksuar argumentet e veta lidhur me vlerësimin e dëshmitarit **S.B.** nga ana e ekspertëve. Ai e konstaton si të pasuksesshme përpjekjen e gjykatës për t'i sqaruar përmes ekspertëve mospërputhjet në deklaratat e dëshmitarëve. Ai i kundërshton të gjeturat e ekspertëve lidhur me gjendjen mendore të dëshmitarëve në vitin 1999 për shkak të periudhës së gjatë kohore që ka kaluar nga ajo kohë. Më tutje, ai i kundërshton konstatimet e ekspertëve duke u bazuar në të gjeturat e përgjithshme lidhur me karakteristikat e dëshmitarëve.

4. Kompetenca e Gjykatës së Apelit dhe ligji në fuqi

Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur përkitazi me ankesat e palëve në përputhje me nenet 17 dhe 18 të Ligjit mbi gjykatat (Ligji Nr. 03/L-199).

Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në përputhje me nenin 19 (1) të Ligjit mbi gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053).

Ligji i zbatueshëm i procedurës penale - *mutatis mutandis* Kodi i Procedurës Penale të Kosovës në fuqi deri më 31 dhjetor 2012

Ligji i procedurës penale i zbatueshëm në këtë lëndë penale është Kodi (i vjetër) i Procedurës Penale të Kosovës i cili ishte në fuqi deri më 31 dhjetor 2012. Interpretimi i duhur i dispozitave kalimtare të Kodit (të ri) të Procedurës Penale (KPP), në fuqi prej datës 1 janar 2013, përkatësisht neni 544 i KPP-së parasheh që “nëse me ankesë anulohet aktgjykimi, shqyrtimi gjyqësor zbatohet përshtatshëm sipas dispozitave të kodit të mëparshëm”. Po ashtu, duke iu referuar edhe mendimit juridik nr. 56/2013 të Gjykatës Supreme të Kosovës, i miratuar në seancën e saj të

përgjithshme më 23 janar 2013, në procedurat penale të iniciuara para hyrjes në fuqi të kodit të ri e për të cilat gjykimi tanimë ka filluar por nuk ka përfunduar me vendim të formës së prerë, do të zbatohen *mutatis mutandis* dispozitat e KPPK-së derisa vendimi të merr formën e prerë.

5. Cështje preliminare të procedurës

Kolegji i Gjykatës së Apelit ka mbajtur seancë për këtë lëndë më 1 tetor 2015 kurse këshillimin e ka mbajtur më 2 tetor 2015.

6. Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Prokurorja speciale e bazon ankesën e saj në shkelje të nenit 403 (1) 12) dhe para. (2) 1) të KPPK-së si edhe në vërtetimin e gabueshëm dhe jo të plotë të fakteve sipas nenit 405 (2) të KPPK-së.

Kolegji i apelit tani do ta shtjellojë secilën shkelje të pohuar e të ngritur nga prokurorja.

Shkeljet e pohuara të dispozitave të procedurës penale

• Shkelje e nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 të KPPK-së

1. Neni i përmendur përcakton me sa vijon:

*“Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse:
(12) Dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij ose me arsyet e aktgjykimit, kur aktgjykimi nuk përfshin arsyetimin ose në të nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare;*

Arsyet janë plotësisht të paqarta ose kundërthënëse në masë të konsiderueshme; ose kur për faktet vendimtare ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave ose të procesverbaleve për deklaratimet e dhëna në procedurë dhe vetë këtyre shkresave dhe procesverbaleve.”

2. Parashtruesja e ankesës nuk e vë në pah se cilës shkelje specifike të përmendur më sipër i referohet. Megjithatë nga përmbajtja e pohimeve të saj, është e qartë, se e vetmja e zbatueshme është kjo e fundit, përkatësisht kundërthënia e konsiderueshme në mes të arsyetimit lidhur me provat e vlerësuara nga gjykata dhe vet provat. Të gjitha këto prova janë të pranueshme. Kolegji i Gjykatës së Apelit i ka vlerësuar provat në shkresat e lëndës dhe në kuadër të kësaj, kolegji nuk gjen asnjë veprim procedural me të cilin janë shkelur dispozitat e procedurës lidhur me provat, gjë e cila do të përbënte shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Kolegji i Gjykatës së Apelit vëren se aktgjykimi bazohet në dokumentacion real provues.

3. Parashtruesja e ankesës ka pohuar se aktgjykimi është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me provat respektivisht me raportin e ekspertizës i cili ka të bëjë me aspektet psikologjike të dëshmisë së palës së dëmtuar S.B.

4. Kolegji duhet të vë në pah se ekspertiza dhe deklaratimet pasuese të ekspertit të cilat i janë dhënë gjykatës duhet të konsiderohen si një tërësi e provave dhe të vlerësohen në kontekst të përgjithshëm të provave të siguruara në procedurë. Më tej, kolegji vëren se gjykata ofron një pasqyrë të gjerë të deklaratimit të ekspertit të gjykatës në faqet 20, 21 të versionit anglisht të aktgjykimit të kundërshtuar. Prezantimi i deklaratës së dëshmitarit është në pajtim të plotë me këtë tërësi të provave, duke i bërë kështu pohimet e parashtruesit të ankesës të parëndësishme. Ky pohim megjithatë nuk përbën shkelje substanciale e paraparë me nenin 403 të KPPK-së por të nenit 405 të KPPK-së e cila do të shtjellohet më poshtë.
5. Për më tepër, parashtruesi i ankesës pretendon se aktgjykimi në fjalë është në kundërshtim me përmbajtjen e provave të tjera, përkatësisht me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, të cilat janë prezantuar ndryshe nga përmbajtja e tyre e vërtetë. Në të vërtetë bëhet fjalë për deklaratat e dëshmitarëve N.K. dhe R. K.
6. Kolegji përsëri është i mendimit se pretendimi i përmendur më lart është i pabazë. Aktgjykimi i kundërshtuar në pjesën e tij lidhur me provat e shqyrtuara i përshkruan deklaratat e dëshmitarit në raport me procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor, prandaj nuk ka mospërputhje që korrespondon me nenin 403, par. 1, pikën 12 të KPPK-së. Prendimet e ankuesit lexohen si kontestim i mënyrës si janë vlerësuar provat. Prandaj, kjo çështje do të shtjellohet më poshtë.
7. Kundërshtimi i fundit në këtë pjesë të ankesës ka të bëjë me vlerësimin e deklaratave të dëshmitarëve në rastin e S.S., përkatësisht deklaratat e B.R., F. R. dhe F. M.. Parashtruesi i ankesës, megjithatë, iu referohet konkluzioneve të gjykatës, të gjeturave të saja duke u bazuar në këto deklarata dhe i konsideron të njëjtat të pasakta. Po ashtu ky pretendim do të shtjellohet në pjesën e cila i kushtohet nenit 405 të KPPK-së.

• **Shkelja e nenit 403, par. 2, pikës 1 të KPPK-së**

8. Parashtruesi i ankesës kishte pretenduar se gjykata e shkallës së parë i kishte përsëritur gabimet e aktgjykimit të parë. Ajo e përkuqton se aktgjykimi i parë ishte anuluar për shkak se bazohej kryesisht në deklaratën e të dëmtuarit S. B., të datës 21.09.2000, e cila ishte marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore për deklaratat e dëshmitarëve.
9. Neni 403, par. 2, pika 1 e KPPK-së përcakton:

(2) Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet edhe kur gjykata gjatë kohës së përgatitjes së shqyrtimit gjyqësor, duke përfshirë procedurën paraprake, gjykatën, prokurorin publik dhe policinë nëse:

1) Nuk është zbatuar ndonjë dispozitë e këtij Kodi ose është zbatuar gabimisht

10. Duhet të përmendet se parashtruesja e ankesës nuk e ka specifikuar se cila dispozitë e KPPK-së ajo konsideron se nuk është zbatuar apo se është zbatuar në mënyrë të pasaktë. Ajo i referohet aktvendimit të mëhershëm të Gjykatës së Apelit të datës 27 korrik 2013. Përveç

kësaj, ajo ngre pretendime edhe lidhur me vërtetimin e fakteve nga gjykata bazuar në provat të cilat janë siguruar në kundërshtim me dispozitat e procedurës penale në fuqi në kohën e marrjes së provave.

11. Gjukata e Apelit dëshiron ta theksojë një aspekt të rëndësishëm lidhur me vlefshmërinë e provave. Sipas nenit 153 të KPPK-së, provat nuk mund të shfrytëzohen nga gjykata për ta mbështetur vendimin vetëm kur papranueshmëria e tyre shprehimisht përcaktohet me ligj. Prandaj, jo të gjitha shkeljet e dispozitave procedurale i bëjnë patjetër të papranueshme provat. Kur ligji nuk e përcakton një pasojë të tillë, shkelja esenciale procedurale gjatë mbledhjes së provave mund të ndodhë vetëm nëse një shkelje e tillë e dispozitave të procedurës ka ndikuar në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe drejtë, në bazë të nenit 403, par. 2.2 të KPPK-së.
12. Kjo është shpallur me pikën 18 të aktvendimit të Gjukatës së Apelit, të datës 25 korrik 2013. Po ashtu është konstatuar se dëshmitari i lënduar S.B. vetëm është marrë në pyetje shkurtimisht rreth mospërputhjes së deklaratave të tija, të cilat gjykata e shkallës së parë i ka konsideruar esenciale. Kjo ishte arsyeja për anulimin e aktgjykimit dhe për kthimin e lëndës në rigjykim.
13. Gjatë zhvillimit të rigjykimit, gjykata e shkallës së parë është koncentruar në këtë çështje duke e ri-dëgjuar edhe një herë dëshmitarin e lënduar, duke i emëruar dëshmitarët ekspertë dhe duke i dëgjuar dëshmitarët e tjerë me qëllim të vlerësimit të deklaratës së dëshmitarëve në mënyrë të drejtë dhe duke i siguruar të gjitha provat në dispozicion lidhur me identifikimin e kryerësve të krimeve të pohuara nga të pandehurit. Pas këtij ndryshimi të provave, të gjitha provat e siguruar janë vlerësuar dhe janë arritur konkluzionet. Edhe pse të gjeturat përfundimtare të gjukatës nuk kanë ndryshuar po qe se krahasohen me aktgjykimin e mëhershëm, pohimet e parashtruesit të ankesës se gjykata i ka përsëritur gabimet duke i injoruar tërësisht vërejtjet e Gjukatës së Apelit, janë pohime të pavenda.
14. Të gjitha pretendimet e ankuesit lidhur me të gjeturat faktike duhet të referohen në kuptimin e nenit 405 të KPPK-së dhe si të tilla do të shtjellohen në vazhdim.

6.b) Vërtetimi i gabueshëm i fakteve

- **Shkelja e nenit 405, par. 2 të KPPK-së**
15. Para adresimit të pretendimeve lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike të përmendura nga ankuesi në të gjitha pikat e ankesës, kolegji dëshiron ta theksojë rëndësinë e jashtëzakonshme të deklaratave të dëshmitarit të dhëna nga pala e dëmtuar S.B.. Ai është pala e vetme e pranishme gjatë të gjitha ngjarjeve që janë objekt shqyrtimi i kësaj lënde i cili në të njëjtën kohë ka qenë në gjendje t'i identifikojë të gjithë dëshmitarët, të cilët kanë qenë fqinj të tij gjatë gjithë jetës në kohën para luftës.
 16. Në fakt janë dy pika të cilat duhet të provohen. Nga njëra anë janë vetë ngjarjet e ndodhura S.B.dhe H.D. në dhe rreth Xxx, midis datave 19 dhe 22 prill të vitit 1999. Kjo pikë është provuar mirë, pasi që nuk është vetëm një deklaratë e vetme e dëshmitarit, por deklaratat e palës së dëmtuar S.B.k onfirmohen edhe me deklaratat e palës së dëmtuar H.D., i cili në

parim i përshkruan ngjarjet në të njëjtën mënyrë. Për më tepër, deklaratat e të dyja palëve të dëmtuara përputhen me raportet mjekësore mbi lëndimet e tyre të pësuar pas liritimit nga paraburgimi dhe përputhen me mekanizmin e lëndimeve të përshkruara nga të dy dëshmitarët. Deklaratat lidhur me vetë faktin e paraburgimit të tyre dhe kushtet e përgjithshme të këtij paraburgimi mbështeten nga deklaratat e dëshmitarëve të tjerë. Kolegji prandaj plotësisht pajtohet me aktgjykimin e kundërshtuar në listën e fakteve dhe provave të provuara e cila është dhënë në faqen 28 të versionit anglisht.

17. Pretendimi i ankuesit se shumë prej këtyre fakteve nuk janë përmendur në deklaratat e mëhershme të S.B. nuk është relevant. Siç është thënë më lart, këto fakte provohen fuqishëm edhe me dëshmitë vërtetuese dhe mbështetëse nga burimet e tjera të pavarura.
18. Pika e dytë e cila duhet të provohet është çështja e identitetit të kryerësve të veprave penale të përmendura më lart. Lidhur me këtë çështje, provat në fjalë janë të kufizuara vetëm në deklaratat e palës së dëmtuar S.B.
19. Kolegji duhet ta theksojë parimin e supozimit të pafajësisë, i cili përcakton që fajësia e të dyshuarit duhet të provohet përtej dyshimit të arsyeshëm, përndryshe i dyshuari konsiderohet i pafajshëm. Duke e pasur parasysh se deklaratat e palës së dëmtuar S.B. janë të vetmet prova me të cilat arrihet të provohet roli i të pandehurve në keqtrajtimin e tij dhe të H.D., kolegji e thekson rëndësinë e madhe të vlerësimit me kujdes të zhvillimit të plotë të procedurës penale.
20. Nuk ka dyshime se deklaratat në fjalë të S.B. ndryshojnë në kohë gjatë procedimit të kësaj lënde. Aktgjykimi i kundërshtuar e jep një pasqyrë të të gjitha deklaratave të tija në faqen 27 të versionit në gjuhën angleze. Është e qartë se të pandehurit si persona të cilët e kishin rrahur për herë të parë përmenden në deklaratën e tij të datës 17.10.2008. Përkundër pretendimeve të ankuesit në faqen 7 në anglisht të ankesës, të cilat shpijnë kah përjashtimi i deklaratave të hershme të S.B. për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, kolegji, duke i pasur parasysh konkluzionet e veta lidhur me pranueshmërinë e provave, siç prezantohet më lart, nuk mund t'i injorojë deklaratat e hershme të dëshmitarëve, siç sugjeron prokurori. Duke i pasur parasysh shkeljet procedurale të pranuar gjatë sigurimit të provave, të cilat nuk e shkaktojnë papranueshmërinë e këtyre provave, gjykatat duhet t'i marrin parasysh deklaratat në fjalë.
21. Duhet ta ritheksojmë se në deklaratën e S.B. të marrë më 21 shtator 2000, nuk figurojnë emrat e të pandehurve, apo më saktësisht nuk figurojnë si individë të cilët e kishin keqtrajtuar atë. Në fakt, aty përmenden të tjerë emra në cilësinë e keqbërësve në vend të të pandehurve në fjalë. Të pandehurit nuk figurojnë askund në këtë kontekst. Kolegji është në dijeni rreth pamundësisë procedurale rreth sigurimit të kësaj deklarate të dëshmitarit, prandaj provën në fjalë e vlerëson në raport me provat e tjera.
22. Çështje tjetër për t'u adresuar është përshkrimi i bërë nga S.B. rreth ngjarjeve në fjalë në deklaratën e shkruar me dorën e tij të datës 10 korrik 2007. Kolegji e vë theksin në kohën e kaluar nga ngjarjet në fjalë derisa është dhënë deklarata e përmendur, si dhe në mungesën e qartë të çfarëdo presioni, pasi që kjo deklaratë është shkruar nga vetë pala e dëmtuar në privatësi dhe pastaj tek pasi është përfunduar i është dorëzuar organeve përkatëse. Edhe pse

- kjo deklaratë i përmend emrat konkretë të individëve të cilët e kanë rrahur S.B. dhe H.D.n, aty përmenden edhe emrat **S.** dhe **S.M.1.** si persona të cilët kanë dashur t'iu ndihmojnë të burgosurve, por për shkak të pozitës së tyre në strukturën ushtarake, ata nuk kanë pasur mundësi të bëjnë diçka të tillë. Në deklaratën e S.B., vetëm **S.S.** përshkruhet si personi që i ka rrahur, por pasi që të gjeturat faktike në rastin e saj janë tjera krahasuar me rastin e dy të pandehurve të tjerë, kjo gjë do të shtjellohet ndaras.
23. Deklarata e datës 17.10.2008 e dhënë nga S.B.i përmend të dy të pandehurit si persona të cilët e kishin rrahur atë. Megjithatë, kolegji duhet t'i përmend faktet të cilat dalin nga provat e tjera. Së pari, është deklarata e I. P., të cilin në dy deklaratat e hershme të tij S.B.e zbulon si personin i cili i kishte rrahur ata. P. e përshkruan bisedën që e kishte pasur me B. dhe betohet se ishte i pafajshëm. Një bisedë e tillë është konfirmuar nga dëshmitari T.B., i cili, megjithatë, nuk e dinte se çfarë përmbante biseda në fjalë. S.B.e ka refuzuar faktin se kishte marrë pjesë në këtë bisedë, por në deklaratat e tija të mëvonshme, më nuk paraqitet emri fillimisht i njërit prej kryerësve kryesorë të veprës penale në fjalë.
24. Çështja e dytë ka të bëjë me grindjen në mes të S.B.dhe **S.M.** në korridorin e komunës, ku ishin të punësuar të dytë. Kjo skenë është përshkruar nga S.B.dhe është konfirmuar nga dëshmitarët B.A. (në deklaratën e tij të vitit 2009 si dhe në shqyrtimin gjyqësor) dhe nga dëshmitari M.G. (në deklaratën e tij të vitit 2009, ndërkaq në shqyrtimin gjyqësor deklarata e tij ishte bishtnuese dhe e pambështetur). Pas të gjitha deklaratave, grindja në fjalë në mes të S.B.dhe **S.M.** ka ndodhur në vitin 2008, më saktë pas deklaratës së M.G., në pranverën e vitit 2008.
25. Duke i pasur parasysh rrethanat në fjalë, kolegji konsideron se emri i **S.M.** si personi i cili e ka keqtrajtuar atë është përmendur në deklaratat e mëvonshme të S.B. (për dallim nga deklaratat e mëhershme të tij), si pasojë e ndikimit të grindjes që ata dy e kishin pasur në komunë, e cila pastaj e kishte shkaktuar sjelljen ndërmend të ngjarjeve armiqësore të dhimbshme nëpër të cilat kishte kaluar S. B..
26. Asnjëra prej këtyre dy të gjeturave të përmendura në pikat 23 dhe 24 nuk mund të konsiderohet si rrethanë e favorshme për besueshmërinë në deklaratat e S. B..
27. Argumentet e shumta të ngritura nga ana e ankuesit kanë të bëjnë me ekspertizën dhe me deklaratat e mëvonshme të dëshmitarëve ekspertë në shqyrtimin gjyqësor. Aty pohohet se gjykata e ka neglizhuar tërësisht mendimin e ekspertëve, përkundër profesionalizmit dhe korrektësisë së tyre. Parashtruesi i ankesës iu referohet motiveve të cilat e kanë shtyrë S.B. si “drejtësi, jo hakmarrje” dhe profilin e këtij dëshmitari si “njeri i mirë...” Për më tepër, ankuesi iu referohet të gjeturave të ekspertëve lidhur me moskuptimin e procedurës gjyqësore nga dëshmitarët, mungesën e përgatitjes së tij psikologjike dhe besueshmërinë e tij të përgjithshme.
28. Kolegji e thekson faktin se dëshmitari është intervistuar nga ekspertët pas shumë seancave të gjata dëgjimore të cilat e kanë detyruar t'i përkujtojë edhe një herë ngjarjet shumë traumatike të jetës së tij. Gjatë gjithë procedurës, ai ka vuajtur nga mungesa e çfarëdo ndihme psikologjike dhe madje nuk e ka pasur të qartë as vetë procedurën. Për më tepër, përsëritja e marrjes në pyetje, kohëzgjatja e këtyre seancave dëgjimore dhe e marrjes në

pyetje nga ekspertët, i ka treguar në mënyrë të qartë dyshimet e gjykatës rreth besueshmërisë së përshkrimit të tij të ngjarjeve në fjalë. Të gjitha këto janë përmendur nga ana e ekspertëve. Në një situatë si kjo ekspertët në fjalë kanë ardhur gjer te konkluzioni se ai vazhdon ta thotë të njëjtën gjë.

29. Mendimi i dhënë nga ekspertët i shpjegon kundërshtitë e gjetura në deklaratat e dëshmitarit lidhur me detajet e sakta të lidhjes së tij të syve, kronologjisë së rrahjes së tij dhe detaje të tjera, të cilat kolegji e konsideron se janë të kuptueshme kur të kihet parasysh kohëzgjatja e këtyre ngjarjeve të dhimbshme, stresi i përjetuar gjatë zhvillimit të tyre e po ashtu edhe seancat e shpeshta dëgjimore të dëshmitarëve. Është e qartë se dëshmitari në fjalë nuk mund t'i përshkruajë ngjarjet jashtëzakonisht të dhimbshme të cilat ia kishin kërcënuar edhe jetën, të cilat kishin zgjatur me ditë të tëra, në mënyrë saktësisht të njëjtë lidhur me secilin detaj, posaçërisht tani kur kanë kaluar nëntë vjet prej tyre. Ekspertët megjithatë nuk e kanë shpjeguar pikën thelbësore të vlerësimit të deklaratave të tija, përkatësisht ndryshimin e kryerësve të identifikuar që nga viti 2008.
30. Kolegji është i bindur se kjo është çështja më e rëndësishme gjatë vlerësimit të provave të cilat kanë të bëjnë me dëshmitarin S.B.. Vetë dëshmitari e jep shpjegimin e gabimeve në procesverbal apo në përkthim ose mungesën e pyetjeve të drejtpërdrejta lidhur me të dy të pandehurit M.. Gjykata e Apelit e ka pranuar këtë shpjegim në aktvendimin e saj të datës 25 korrik 2013 lidhur me deklaratën e parë të dëshmitarit nga viti 2000. Kolegji megjithatë nuk mund ta pranojë këtë sqarim edhe për deklaratën e vitit 2007, në të cilën nuk ka pasur as përkthyes as organ i cili parashtron pyetje. Përkundër kësaj, vetë dëshmitari i ka përmendur emrat e dy të pandehurve, por i ka prezantuar të njëjtit si persona që janë munduar të ndihmojnë dhe jo si kryerës.
31. Kolegji edhe një herë dëshiron ta theksojë parimin e supozimit të pafajësisë si mbrojtje kryesore për personin e akuzuar për krimin, i cili kërkon që fajësia e të pandehurit të provohet brenda standardeve *përtej dyshimit të arsyeshëm*. Siç përcaktohet me nenin 3, par. 2 të KPPK-së, dyshimet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme të këtij rasti do të interpretohen në favor të të pandehurit (*in dubio pro reo*). Dyshimet në fjalë nuk mund të zgjidhen në mënyrën e sugjeruar prej ankuesit duke mos i marrë parasysh deklaratat e hershme të palës së dëmtuar, edhe pse të njëjtat janë prova të pranueshme. Lidhur me këtë, kolegji e thekson se të gjitha deklaratat e pranueshme duhet patjetër të vlerësohen në hollësi dhe të shqyrtohen me kujdes. Pas një vlerësimi të tillë, kolegji thekson se ndryshimi i deklaratave të dëshmitarit prej vitit 2008 dhe rrethanat e përmendura më lart, i bëjnë këto dyshime edhe më të bazuara, gjë e cila e parandalon kolegjin për ta konsideruar identifikimin e të pandehurve si kryerës të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm, duke u bazuar vetëm në deklaratat e tij.
32. Pretendimet tjera të parashtruesit kanë të bëjnë me vlerësimin e provave të tjera, përkatësisht të deklaratave të dëshmitarëve të tjerë. Deklaratat e dëshmitarëve N. K. dhe R. K. përmenden vetëm në rishikimin e provave të proceduara, por jo edhe në vlerësimin e provave dhe në të gjeturat e gjykatës. Është e qartë se deklaratat e tyre nuk kanë pasur ndikim në të gjeturat përfundimtare të gjykatës. Përveç kësaj, dëshmitarët në fjalë nuk kanë thënë asgjë lidhur me paraburgimin e palëve të dëmtuara. Ata nuk kanë sjellë asnjë provë të vetme me të cilën do të provonin përfshirjen e cilitdo të pandehur në rrahjen e S.B.dhe H.D..

Kolegji i konsideron ato të parëndësishme dhe është i mendimit se të njëjtat janë përmendur në aktgjykim vetëm sa për ta shfaqur përmbajtjen e tyre.

33. Lidhur me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë të cilët ishin burgosur në Xxx dhe konkluzionet pasuese të parashtruesit të ankesës lidhur me këtë (faqet 8 dhe 9 të ankesës në anglisht), kolegji është i mendimit se të njëjtat nuk janë asgjë më tepër sesa përralla pa asnjë bazë provuese. Prokuroria e thekson se dëshmitarët F. N., F. I. dhe R. N. kanë deklaruar se të pandehurit iu kanë dhënë ushqim. Përveç kësaj, ata kanë deklaruar se janë rrahur nga ushtarakë që mbanin maska, prandaj nuk kanë mundur t'i njihnin. Ankuesi konkludon se të pandehurit kanë mundur t'i rrihnin të paraburgosurit derisa kanë mbajtur maska dhe ndërkohë kur iu kanë dhënë ushqim atyre kanë qenë pa maska, në mënyrë që ta përgatitnin terreni për të jetuar edhe më tej në Kosovë në rast se do ta humbnin luftën. Nuk ka prova që e mbështesin këtë. Konkluzionet lidhur me dashjen e mundshme të të pandehurve pa pasur asnjë bazë në prova nuk janë të pranueshme dhe nuk mund të prezantohen si prova të fajësisë së tyre.
34. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për mungesën e interesimit të të pandehurve rreth detajeve të mbajtjes së palëve të dëmtuara. Të pandehurit e kanë pranuar se nuk i kanë kërkuar detajet në fjalë, por e kanë shpjeguar se ata kanë qenë vetëm ushtarë të thjeshtë të cilët nuk kanë pasur asnjë mundësi për t'iu ndihmuar fqinjëve të tyre. Ky fakt përputhet me dëshmitë e dëshmitarëve F.N. dhe F. I. të cilët kishin deklaruar se serbët nuk kanë qenë në gjendje t'iu ndihmonin dhe se ata të cilët mundoheshin t'iu ndihmonin arrestoheshin. Duhet theksuar se mungesa e interesimit, në veçanti në rrethanat në fjalë, nuk e provon pjesëmarrjen e të pandehurve në ngjarjet e pohuara.
35. Mund të shtojmë se dëshmitarja B. R., e cila e kishte pranuar se e kishte pasur një vizitë në shtëpinë e saj nga i pandehuri **S.M.** ishte deklaruar se përkundër marrëdhënies miqësore me të dhe përkundër asaj se ajo e dinte se S. ishte ndaluar, prapë nuk kishte kërkuar nga ai lirin e tij.
36. Është vërtetuar nga kolegji se kjo provë nuk është e mjaftueshme për ta formuar pjesën kryesore të veprës penale për të cilën të pandehurit janë akuzuar në fillim.
37. Kolegji tash do ta shqyrtojë përfshirjen e të pandehurës **S.S.** në veprën penale në fjalë. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të shkresave të lëndës si dhe të provave në tërësi, kolegji konstaton se rasti i të pandehurës **S.S.** ndryshon nga rasti i dy të pandehurve të tjerë. Përfshirja e saj në keqtrajtimin e palëve të dëmtuara është përmendur për herë të parë në deklaratën me shkrim të dhënë nga S.B. në vitin 2007.
38. Siç është shpjeguar në mënyrë të qartë edhe në aktgjykimin e kundërshtuar, kryerësi i krimeve të luftës mund të jetë pjesëtar i një organizate ushtarake, politike apo administrative të njëres palë në konflikt apo edhe çdo person që vihet në shërbim të saj. Çështja e përfshirjes së të pandehurit në konfliktin e armatosur në Kosovë dhe mundësia e saj personale që të jetë kryerëse e krimit të luftës është çështja bosht në rastin e saj.
39. Është përmendur edhe më parë se **S.S.** para luftës kishte punuar në kioskë dhe këtë punë e kishte vazhduar ta kryente edhe gjatë konfliktit luftarak. Vetë e pandehura kishte deklaruar

se kishte punuar në kioskë dhe e kishte mohuar në tërësi se kishte qenë e përfshirë në çfarëdo aktiviteti në kuadër të konfliktit ushtarak. Dëshmitari S.B. në deklaratën e tij të vitit 2007, kur e kishte përmendur për herë të parë emrin e të pandehurës, nuk e kishte shpjeguar pozitën e saj në strukturën ushtarake por vetëm kishte deklaruar se kohëve të fundit (në vitin 2007) e njëjta e mban të veshur uniformën e ShPK-së. Ndërkaq në deklaratën e tij të mëvonshme ai e përshkruan të njëjtën se kishte të veshur uniformë ushtarake. Vlerësimi i deklaratave të tij lidhur me të pandehurën në fjalë është bërë në arsyetimin e aktgjykimit të parë të Gjykatës së Qarkut të datës 22 korrik 2011 dhe atë në faqet 12 dhe 13 dhe nuk ka qenë objekt i ndonjë kontestimi me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të datës 25 korrik 2013. Rishikimi i mospërputhjeve në deklaratat e S.B. përsëritet edhe në aktgjykimin e kundërshtuar në faqen 26 të versionit në anglisht. Kolegji është i bindur se për shkak të këtyre dallimeve brenda për brenda procedurës komplete penale, deklaratat e S.B. nuk mund të shërbejnë si bazë për ta provuar standardin e dyshimit të arsyeshëm lidhur me rolin e të pandehurës në fjalë.

40. Ankuesi iu referohet deklaratave të dëshmitarëve B.R., F. R. dhe F. M., të cilët pohohet se e vërtetojnë statusin ushtarak të të pandehurës **S.S.** Kolegji i ka vlerësuar deklaratat e këtyre dëshmitarëve dhe ka ardhur deri tek këto përfundime:

40.1 Dëshmitarja B.R. vazhdimisht ka deklaruar se e ka parë shpesh të pranishme në qendrën ushtarake në Xxxx të pandehurën **S.S.**, por nuk e ka përshkruar qëllimin e vizitave të saj. Dëshmitarët tjerë kanë deklaruar se njerëzit nga Xxx vinin në këtë qendër t'i shihnin të burgosurit. Vetë fakti se e pandehura në fjalë ka qenë aty, siç përshkruhet nga B. R., nuk e provon pjesëmarrjen e saj në strukturën ushtarake. Përveç kësaj, ky dëshmitar në vazhdimësi ka deklaruar se e pandehura nuk ka pasur të veshur asnjë uniformë dhe se vetëm pas konfliktit ajo e kishte veshur uniformën e xxx, përderisa gjatë konfliktit e njëjta kishte punuar në xxx.

40.2 Dëshmitari F.R. ka deklaruar se e pandehura në fjalë ka qenë tërë kohën në uniformë gjatë konfliktit edhe pse nuk ka qenë në gjendje të japë detaje të uniformës së saj. Është e qartë nga shkresat e lëndës se ky dëshmitar ka lindur në gusht të vitit xxx, prandaj gjatë luftës ka qenë xxx vjeç (i njëjti ka deklaruar se i kishte pasur xxx vjet). Deklarata e tij është në kundërshtim të plotë me deklaratën e nënës së tij. Për shkak të moshës së tij gjatë kohës së luftës, kolegji nuk mund ta konsiderojë deklaratën e tij si provë të paluhatshme të pozitës ushtarake të të pandehurës në fjalë. Duke e ditur se deklarata e tij është në kundërshtim me provën tjetër, përshkrimi i tij i uniformës në fjalë është i paqartë dhe është provuar se e pandehura ka mbajtur uniformën policore pas përfundimit të konfliktit, prandaj kolegji është i mendimit se këto çështje mbase kanë ndikuar në perceptimin e dëshmitarit lidhur me personalitetin e të pandehurës.

40.3 Dëshmitari F.M. ka deklaruar se e pandehura **S.S.** ka pasur të veshur uniformën kur i kishte rrahur palët e dëmtuara, porse përshkrimi i tij i bërë aktit në tërësi ndryshon nga përshkrimi i palëve të dëmtuara. Dëshmitari ka deklaruar se janë sjellë në oborrin e shkollës me traktor, janë rrahur dhe pastaj janë vendosur në një kontejner. Po ashtu ai e kishte identifikuar personin (**S.M.1.**) si një prej kryerësve të rrahjes jashtë shkollës që nuk përputhet me asnjërin version të S. B.. Për këto arsye, deklarata e dëshmitarit F.M. e vlerësuar në raport me të tjera deklarata të dëshmitarëve, përfshirë këtu edhe deklaratën e

B. R., e cila ka qenë konsekuente gjatë tërë procedurës, nuk e mbështet konkluzionin e përfshirjes ushtarake të të pandehurës përtej dyshimit të arsyeshëm.

41. Siç është përshkruar më lart, provat e proceduara në këtë lëndë nuk kanë provuar se **S.S.** ka qenë pjesëtare e një organizate që i ka takuar një pale ushtarake, politike apo administrative të konfliktit, as person në shërbimin e tyre. Kolegji dëshiron ta theksojë se për përgjegjësinë penale lidhur me krimet e përshkruara në aktakuzë, vetë kryerja e akteve nuk është e mjaftueshme, pasi që përfshirja e kryerësit në strukturën ushtarake është pjesë përbërëse e meritave.

42. Vërejtjet përmbyllëse

Për arsyet e shtjelluara më lart, Gjykata e Apelit e ka refuzuar ankesën e prokurorit si të pabazë dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e kundërshtuar.

Shpenzimet e procedurës penale do të paguhen nga burimet buxhetore.

Siç është thënë më lart, në bazë të nenit 420 (2) të KPPK-së, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv.

Aktgjykimi është përpiluar në gjuhën angleze.

Kryetari i kolegjit:

Roman Raab, gjyqtar i EULEX-it

Anëtarët e kolegjit:

Driton Muharremi
gjyqtar kosovar

Elka Filcheva-Ermenkova
gjyqtare e EULEX-it

Procesmbajtëse:

Vjollca Kroçi - Gërxhaliu, këshilltare ligjore e EULEX-it

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR nr. 146/15

2 tetor 2015

(përfunduar më datën 17 nëntor 2015)